



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 5582/2026
Data: 22.06.2026

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e pestë -V- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 28.05.2026, me fillim pune në ora 11:00, në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: Mehmet Ballazhi (Kryetar i Komunës), Abduraman Bushi (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Arbenita Bajramaliu (Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport), Senad Kalisi (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), Bashkim Sopa (Zyrtar për Transparencë).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Propozim vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës "Parku dhe Ujëvara" Hani i Elezit.
3. Propozim vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës "Kanioni " Dromjak -Hani i Elezit.
4. Propozim vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës "Trungu i Bungëbutës" në Dromjak -Hani i Elezit.
5. Propozim vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës "Kepi i Gjatë dhe burimi i ujit" Pustenik.
6. Informatë mbi gjendjen në mjedis në Han të Elezit për vitin 2025.
7. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim rendin e punës; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi thekson: - Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin. Nëse nuk ka, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Propozim-vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës “Parku dhe Ujëvara”, Hani i Elezit

Kryesuesi thekson: - Për këtë pikë të rendit të punës, hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson: Ky propozim-vendim ka të bëjë me shpalljen si monument natyror të parkut dhe ujëvarës. Vitin e kaluar, Instituti për Mbrojtjen e Trashëgimisë Natyrore, së bashku me zyrtarët tanë, kanë identifikuar disa vlera natyrore me potencial për t'u klasifikuar si monumente natyrore. Ata, pas debatit publik, i kanë përzgjedhur katër vlera natyrore. Ne i kemi përfunduar të gjitha procedurat ligjore, instituti ka hartuar elaboratin për këto vlera të trashëgimisë natyrore. Është mbajtur debati publik dhe ju kemi drejtuar Ministrisë së Planifikimit Hapësinor për pëlqim paraprak dhe në muajin prill Ministria e Mjedisit na ka dhënë pëlqim për këto vlera të trashëgimisë natyrore dhe tani është radha te ju që, me vendim të veçantë, me i miratuar këto vlera. Parku dhe Ujëvara në Hani të Elezit është monument natyror me karakter hidrologjik dhe në material i keni të dhënat më të rëndësishme për këto vlera. Përveç materialit, të cilin ua kam përcjellë, diçka të veçantë nuk kam.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROPOZIM-VENDIMI PËR MBROJTJEN E VLERËS SË NATYRËS “PARKU DHE UJËVARA”, HANI I ELEZIT

3. Propozim-vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës “Kanioni” Dromjak - Hani i Elezit

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës, hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson: Përveç materialit, të cilin ua kam përcjellë, diçka të veçantë nuk kam.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROPOZIM-VENDIMI PËR MBROJTJEN E VLERËS SË NATYRËS “KANIONI DROMJAK”, HANI I ELEZIT

4. Propozim-vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës “Trungu i Bungëbutës” në Dromjak - Hani i Elezit

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës, hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson: Përveç materialit, të cilin ua kam përcjellë, diçka të veçantë nuk kam.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROPOZIM-VENDIMI PËR MBROJTJEN E VLERËS SË NATYRËS “TRUNGU I BUNGËBUTËS” NË DROMJAK – HANI I ELEZIT

5. Propozim-vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës “Kepi i Gjatë dhe burimi i ujit”, Pustenik

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës, hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson: Përveç materialit, të cilin ua kam përcjellë, diçka të veçantë nuk kam.

Menduh Vlasi thekson: Edhe në KPF kam potencuar që, në parim, jam për kësaj pike, sepse jam përkrahës i mbrojtjes së natyrës. Gjithashtu, drejtorin e përgëzoj se rrallëherë vjen material më i kompletuar sesa ka ardhur tash, dhe kështu duhet të vijë një propozim-vendim. Kështu duhet të kërkojmë që propozim-vendimi të vijë në letër me argumente dhe pastaj me marrë vendim, në mënyrë që të mos krijojmë njëfarë kulture që me marrë vendim e nuk e dimë për çka. Për mua është shumë me rëndësi që uji me hyjë në mbrojtje, por në KPF e theksova që Hani i Elezit po përballet me mungesë të ujit dhe a keni menduar ndonjëherë që ndoshta do të na vijë puna që prej fshatarëve të kërkohej që atë ujë me kyç në ujësjellës. Unë jam pro për me ruajtë, por shpresoj që duhet të ruhen të gjitha, jo vetëm uji, sepse unë kam bindje që ujin munden me marrë fshatarët dhe mos me na pyetur, po ashtu edhe gurin, por këto objekte që hyjnë me vendim të Kuvendit realisht duhet të mbrohen, nëse duam me funksionuar si shtet. Një ndër vendimet më të rëndësishme janë këto vendime për mua, që po mbrojmë diçka në komunën e Hanit të Elezit.

Nexhmedin Daci thekson: Këto janë në bazë të standardeve të organizatës botërore ndërkombëtare për mbrojtjen e trashëgimisë natyrore, janë të shkallës së tretë dhe konservohen, dhe nuk lejohet me iu ndryshuar pamja, dhe çka do që punohet aty duhet leje e veçantë e Ministrisë.

Sead Vila thekson: Edhe unë e mirëpres fokusin edhe te uji, edhe te toka, te ajri edhe te faktorët e tjerë, të cilët janë të rëndësishëm. Emërtimet a janë të njohura ligjërisht apo i keni emërtuar sipas toponimeve të qytetarëve, sepse ka edhe në zonën Paldenicë, Neçafcë, lokacion Kepi i Gjatë, dhe kur e pashë mendova se atje. A janë përfshirë të gjitha apo në të ardhmen ka edhe pika të tjera që janë të rëndësishme për mbrojtjen e vlerës natyrore?

Nexhmedin Daci thekson: Sa i përket emërtimeve, i kemi toponimet tona, të cilat i kemi marrë parasysh, dhe mundet me ndodhur që Kepi i Gjatë ka edhe diku tjetër, por kjo është e njohur. Sa i përket vlerave të tjera, ata kanë hasur edhe në vlera të tjera, por nuk është mirë që edhe na me u ngarkuar me shumë vlera të trashëgimisë kulturore për një herë, se nuk është ajo që të shpallim një vlerë trashëgimore e pas tre muajve nuk e ki, për shkak se dikush duhet të përkujdeset. Instituti ka potencuar se kanë me punuar vazhdimisht në këtë drejtim, kanë hasur edhe në vlera të tjera që janë në pronë private dhe janë shumë të vjetra, por ka bërë kërkesë personi z. Isuf Berisha dhe ia kemi miratuar në bashkëpunim me institutin. Ata kanë parë vlera të rëndësishme te pishat në fshatin Neçafcë dhe te pishat në fshatin Gorancë. Në të ardhmen ka me vazhduar ky aktivitet, por nuk është mirë për neve si komunë, për herë të parë, me thënë shumë vlera, se duhet përkujdesje e veçantë, por për një herë është mirë të nisemi me këto.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROPOZIM-VENDIMI PËR MBROJTJEN E VLERËS SË NATYRËS “KEPI I GJATË” DHE BURIMI I UJIT “PUSTENIK”

6. Informatë mbi gjendjen në mjedis në Han të Elezit për vitin 2025

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hap diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson: Unë e kam përgatitur një informatë për gjendjen në mjedis në Han të Elezit për vitin 2025 dhe, fillimisht, në informatë i kemi paraqitur burimet kryesore të ndotjes, siç janë industria, qarkullimi i madh i veturave, i mauneve në territorin, sidomos në Han të Elezit, si dhe përdorimi në masë të madhe të masës drusore gjatë sezonës së dimrit për ngrohje. Në informatë i kemi paraqitur rezultatet në mënyrë tabelare të monitorimit të cilësisë së ajrit nga stacioni për monitorim që është i vendosur te shkolla fillore për parametrat e dioksidit të sulfurit, monoksidit të karbonit, dioksidit të azotit. Kemi paraqitur edhe krahasimin për një vit më herët. Rezultatet për vitin 2025, pak a shumë, janë pak më të mira se në vitin 2024 dhe kjo, për mendimin tim, është se Sharrcemi në vitin e kaluar nuk ka punuar në muajt shkurt, mars, prill. I kam paraqitur edhe dy tabela të tjera; njëra ka të bëjë me vlerat mesatare mujore për monoksidin e karbonit, PM 10 dhe PM 2.8. Me qëllim të krahasimit të ndotjes së ajrit në situatat kur punon kompania Sharrcem dhe kur nuk punon, pra në tabelë mundeni me parë që për muajt shkurt, mars, prill, kur nuk ka punuar Sharrcemi, ndotja ka qenë më e madhe, ndërsa kur është futur në funksion Sharrcemi, ndotja ka qenë më e vogël dhe kjo është një dëshmi që nuk është kompania Sharrcem i vetmi ndotës kryesor i ajrit në Han të Elezit, por është edhe qarkullimi i madh i veturave, kryesisht vetura të vjetra, kamionët dhe natyrisht edhe papastërtitë e rrugëve. Djegia e druve në masë të madhe gjatë sezonës së dimrit edhe ajo ka impakt jashtëzakonisht të madh në ndotjen e ajrit dhe atë mundeni me vërejtur gjatë muajit tetor deri në muajin prill apo maj, që ndotja është shumë më e madhe sesa muajve të verës. E kam paraqitur një tabelë që me i parë krahasimet edhe me qytetet tjera të Kosovës dhe, në bazë të kësaj që i ka paraqitur stacioni, nuk është që qëndrojmë keq. Në material i keni të dhënat për ndotjen e tokës dhe ujit. Për ujin ju e dini se të gjitha kanalizimet, jo vetëm të Hanit të Elezit, por prej Ferizajt e këndeje, derdhen në lumin Lepenc. Edhe toka, për shkak të aktivitetit të Sharrcemit dhe industrisë, është mjaft e ndotur.

Menduh Vlashi thekson: Ky material është i mangët për shkak se ka pasur mundësi edhe më shumë me shkruar. Sa herë inspektorët e komunës ia kanë tërhequr vërejtjen kompanisë Sharrcem, mirë do të ishte me u shënuar në informatë; a kanë marrë ndonjë masë kur ka pasur ndotje, sepse nuk shënon asgjë, për shkak se këto shënime janë marrë prej institutit dhe këtij instituti nuk i besoj aspak se në muajt janar, shkurt, mars, kur është remonti, ka pluhur më shumë, sepse kamionët janë të njëjtë dhe bile janë më shumë kur punon, dhe atë pluhur që e bëjnë kamionët kur është tu punuar është pluhur i fabrikës, por kamionët e kufirit vazhdimisht në krejt muajt janë, që do të thotë se shumë e pakuptimtë është se fabrika është në remont, nuk punon, ka pluhur më shumë sesa kur punon, e që për mua është absurd dhe nuk i besoj. Kush mundet me më bindur mua që Prizreni e ka ambientin më të ndotur se Hani i Elezit, ku krejt mediat, parlamenti e partitë politike potencojnë që Hani i Elezit, pas Obiliqit, është komuna më e ndotur, ndërsa sipas kësaj informate del që jemi mirë, nuk ka pluhur, por realiteti është se pluhuri shihet këtu. Po qe se e marrim veturën dhe e lëmë njëzet e katër orë te kufiri, kur të kthehesh duhet me e larë se ka pluhur. Në Prishtinë e kam lënë dy ditë, ka, por ka shumë pak në krahasim me Hanin e Elezit.

Mehmet Ballazhi thekson: Sikur ty qysh nuk po mundesh me kuptuar, edhe unë me të vërtetë nuk po mundem me kuptuar kujt duhet me i besuar që Hani i Elezit është në suaza apo në parametra normalë të pastërtisë. Ne jemi të prirë me i besuar institucionit dhe institucionet i kanë matësit e tyre, dhe nëse ata mashtrojnë, me iu drejtuar me një shkresë atyre dhe me iu thënë që po na mashtrojnë këto matje, dhe mos të bëhemi qesharakë, sepse ty e din që e kemi diskutuar edhe në jetën e përditshme, ku në Shqipëri i bënin matjet e shpejtësisë së makinës për me dënua, e din siç e bënin, por unë nuk po e di se me çfarë matësi po e matin papastërtinë në Han të Elezit. Prishtina nuk do me thënë që nuk është e ndotur, por vetëm ai pluhuri që po e shihni me sy ka me qenë i ndotur, por ka edhe gaze që e ndotin, që Prishtina është e mbingarkuar, që mundemi me pas probleme me organet e frymëmarrjes, që ne nuk i shohim. Atë pluhurin që e sheh me sy, atje në Prishtinë nuk e sheh me sy. Nuk po dua me thënë që Hani i Elezit është i pastër njëqind për qind, tu e ditë që e kemi fabrikën e çimentos, po nëse krahasohet me ndër më të pastërtit në krahasim me Obiliqin, Prishtinën, Prizrenin që e potencove, sigurisht që dikush ka pasur statistika të matjes së ndotjes së ajrit në këto komuna që i përmende ti dhe ne jemi të prirë me besuar në këto. Nëse je skeptik ti në vërtetësinë e këtyre, atëherë drejtoju organeve të monitorimit të matësve.

Nexhmedin Daci thekson: Na jemi vazhdimisht në kontakt me ta dhe menjëherë kanë shkuar zyrtarët tanë, kemi bërë procesverbalin dhe e kemi njoftuar Ministrinë e Mjedisit, për shkak se nuk kemi të drejtë që për këto raste me dënua, sepse kjo është nën mbikëqyrje të Ministrisë. Çka do që kemi vërejtur ne, menjëherë i kemi lajmëruar dhe, pavarësisht përgjigjes që na kanë dhënë, i kemi njoftuar inspektorët e nivelit qendror. Ku kemi të bëjmë me pluhur, vërehet, por më shumë kemi të bëjmë me ndotjen e gazrave të cilat lirohen dhe ato janë të dëmshme. Unë po të garantoj që Prishtinën e ke të ndotur sa i përket ajrit, sidomos gjatë sezonës së dimrit. Në informatë e kam potencuar se këto rezultate nuk janë bindëse, sepse këtu këta të cilët janë në afërsi të Sharrcemit dhe Magjistrales normalisht që ndotja është më e madhe, por ne nuk kemi mundësi magjistralen me mbyllur. Pastaj nuk na lejohet me ligj që veturat e vjetra mos me i lënë në qarkullim, por është çështje e vetëdijes dhe ndërgjegjes së njerëzve.

Menduh Vlasi thekson: Ato kamionë dhe vetura janë edhe në muajin janar, kur fabrika nuk punon. Ato kamionë që punojnë në Sharrcem janë ndotje e Sharrcemit dhe është problemi që ju po mundoni me riaktivizuar gjendjen që i keni punët mirë. Unë i kuptoj që i keni punët më mirë se më herët, por nuk duhet të thirremi më herët, por çka jemi tu bërë tash. Ne duhet vazhdimisht që të kërkojmë që ambienti të jetë më i pastër, se këtë e kam potencuar edhe kur kam qenë në pushtet, jo vetëm tash, por e kam potencuar edhe kur kam qenë edhe për lejen mjedisore. Së pari, gabimi kryesor është bërë kur është vendosur stacioni monitorues atje dhe, thjeshtë për me kuptuar, atë stacion merre dhe vendose te Alba, nuk ka pluhur se e barët. Vazhdimisht kam kërkuar, Qeveria apo Ministri, kushdo qoftë, por komuna duhet me insistuar, se për atë e keni mor votën e qytetarit për me ja përmirësuar jetën qytetarit në gjitha aspektet. Ju duhet të kërkonit që ai monitorues ose duhet ta ndërron pozitën, ose me vendosur një monitorues tjetër transparent. Nuk mundem me i besuar individit që shkon aty, i merr shënimet dhe t'i jepë. Një gjë po ju them, që sëmundje ka shumë më shumë në Han të Elezit se sa në Prizren, merrme me përqindje apo në qytete tjera. Më kujtohet rasti sa jemi bërë komunë, por nuk më kujtohet viti, kur jemi ardhur në komunë në ora tetë, nuk ke mundur me vërejt se çfarë veture është për shkak të pluhurit. E kemi thirr Ministrinë, kanë shkuar te aparati dhe kanë potencuar se në gjendje normale është. Si me i besuar atij personi? Ne duhet të gjithë gjendjen e ambientit ta përmirësojmë dhe dukuritë negative duhet mos t'i fshehim.

Nexhmedin Daci thekson: Sa i përket atij stacioni, unë personalisht jam kundër që me zhvendosur me ndonjë vend tjetër, për shkak se aty ki numër shumë të madh të nxënësve të shkollës fillore, është çerdhja dhe parku. Unë e di që ka nevojë edhe për tjera lagje, por pajisjet janë të shtrenjta që me i vendosur, apo tri pajisje nëpër pika, por edhe mirëmbajtja është e shtrenjtë. Së bashku me drejtorin e shkollës fillore "Ilaz Thaç" dhe me përfaqësuesin e Ministrisë kemi hyrë brenda dhe shënimet janë të lidhura me softuer, sepse njëmbëdhjetë stacione janë në Kosovë dhe të gjitha këto mundesh me i verifikuar, por për besimin nuk mundem me të detyruar ty për me besuar.

Sead Vila thekson: Ne dimë që edhe ndotja ka qenë shqetësim dhe preokupim i qytetarëve, por nëse e bëjmë një krahasim me të kaluarën, ne duhet ta pranojmë se gjendja është shumë më e mirë, por nuk do me thënë se është perfekte. Me që jemi komunë që varemi shumë nga industria, jo vetëm nga Sharrcemi, por është Terminali, gurëthyesit e të tjerët. A ju ka shkuar ndonjë herë ndërmend për me propozuar buxhet specifik, sikur se rasti i Obiliqit, krahas buxhetit të rregullt që e ka komuna, dhe nëse nuk e keni bërë, do të ishte mirë që në të ardhmen me bërë. Kjo duhet të kalon përmes parlamentit, por me gjet fakte dhe argumente për me i grumbulluar të dhënat e mjaftueshme që edhe komuna jonë, që ndoshta nuk është e para, por mund të jetë e dyta apo e treta në nivel të Kosovës.

Nexhmedin Daci thekson: Ne e kemi menduar edhe më herët kur është bërë Ligji për komunën e Obiliqit, por seriozisht po ju them që me këto parametra Hani i Elezit as që vjen në shprehje me u futur në këtë ligj. Ju mundeni mu mos me më besuar, por keni burime të tjera dhe mund të hyni në internet dhe përcjellin stacionet e tjera që i ka Instituti Hidrometeorologjik, të cilat në çdo muaj i publikon, edhe të dhëna të tjera, dhe keni me pa që numër i madh i qytetarëve në Kosovë kanë ndotje më të madhe se në Han të Elezit. Nuk qëndrojnë më ato që thuhet KEKU, Obiliqi dhe Hani i Elezit i dyti, nuk qëndrojnë më ato, të jeni të bindur, por unë nuk kam si me ju bindur juve. Hyni në Institutin Hidrometeorologjik, për çdo ditë mundeni me i përcjellë. Me këto parametra mundeni me bërë kërkesë, por nuk vjen në shprehje me qenë përfitues.

Medina Imishti thekson: Unë i kam disa statistika të rasteve me kancer nga viti 2013 deri në vitin 2018, që kanë qenë 60 raste të vdekjeve me kancer në Han të Elezit, e që 44 prej tyre kanë qenë me kancer në mushkëri. Më intereson me ditë se deri në vitin 2025 a keni statistika se sa raste të vdekjeve në Han të Elezit kanë qenë me kancer të mushkërive.

Mehmet Ballazhi thekson: Ne jemi munduar me marr statistika, por ka disa statistika që janë të regjistruar, që marrin trajtim në QKMF Hani i Elezit, por nuk janë të sakta për shkak se një pjesë e tyre nuk marrin trajtim në Han të Elezit fare dhe nuk regjistrohen. Ato statistika të cilat i kemi marrë mund t'i dërgojmë me shkrim, se drejtoresha i ka statistikat e institucionit.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës. Nëse nuk ka, kalojmë në pikën e radhës sipas agjendës.

8. Të ndryshme

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hap diskutimin.

Menduh Vlasi thekson: Pyetje kam parashtruar për çështjen e ujit, por nuk e keni në plan për t'u përgjigjur, e që po e shkëlqi Ligjin. Mbani mend se do të kemi debate televizive dhe mos mendoni që i harroj, por unë kam për t'i kërkuar që të m'i sjellin me shkrim dhe, nëse nuk i sillni, nuk mundem me dhunë t'i marr. Te lejet ndërtimore, herën e parë e falënderova, se e ka obligim. Sa i përket çështjes së ujit, që nga dita e nesërme merrni dy apo tre persona, por edhe mua më keni, dalim i shikojmë burimet e ujit. Po që se dilni te uji i Dimcës, ajo pjesa akumuluese e ujit i përngjan një moçali dhe ai ujë i moçalit hyn në fabrikë, dhe dilni publikisht e potencioni që uji është i papijshëm. Nesër ose pasnesër, nëse ndodh ndonjë epidemi, mbani përgjegjësi, se ju jeni përgjegjës për t'ua siguruar ujin e pijes qytetarëve. Gjithashtu, njëjtë edhe ujësjellësi i ujit të Gllloboçicës. Kur të duash, thirrëm, dalim në këmbë e shikojmë trasenë dhe keni me parë se çfarë tmerri është. Pusetat janë të rregulluara në mënyrë moderne, të mirë, por krejt janë të thyera kapakët dhe të mbuluara me dhe. Kur bie shi, hyn së bashku me dheun në ujësjellës, por aty mund të hyjnë edhe kafshët e vogla. Pra, nuk janë të mbuluara shumica e pusetave. Prandaj, bëni një shkresë dhe potencioni se nuk keni informata për cilësinë e ujit. Te lejet ndërtimore, atëherë të thashë respekt që i ke pranuar, por jo të plota, sepse kam kërkuar leje ndërtimore për secilin, por ti e ke përshkruar Ligjin, por mua më intereson se në cilin Ligj je thirrur, në cilin udhëzim administrativ. Potencohet që dhjetë metra në skaj të rrugës, por unë di objekt që nuk i ka dhjetë metra. Potencohet podrumi, përdhesa, pesë kate, por diku ka dy kate e është tre kate, që do të thotë se nuk iu kanë përmbajtur rregullave. Ju mund të thoni që nuk na kanë pyetur, por ju jeni përgjegjës, se inspektori duhet t'i thotë: ndal, se nëse e ke për dy kate, dy kate mbetet; nëse e ke për tre kate, tre kate mbetet, e jo të shtohen, sepse nëse ndodh ndonjë lëvizje, ju e dini që në Shqipëri janë burgosur personat. Mbani mend se një ditë ka me funksionuar shteti, ka me funksionuar ligji. Do të shkojë dikush në përgjegjësi për këtë çështje, për lëshimet që i bëjmë. Në një anë kërkoni legalizimin e shtëpive, ndërsa në anën tjetër vazhdimisht ndërtohen objekte pa leje para syve tuaj dhe tanëve. Së pari duhet t'i ndalim ndërtimet pa leje, sepse nëse vazhdon ndërtimi i objekteve pa leje, do ta kemi vështirë legalizimin e atyre objekteve që vijnë pas.

Mehmet Ballazhi thekson: Me thënë të drejtën, e kam pasur me shkrim atë ditë, por e lëshuat mbledhjen dhe, para se me filluar me mbledhjen, të thash që e kam. Mirëpo, ju e lëshuat për arsye të juaja politike. Ne nuk po potencojmë që uji është i pastër njëqind për qind pa i pasur analizat, por i kemi marrë prej tyre, ata që i bëjnë, IKSHPK-ja. Na nuk bëjmë analiza, por kërkojmë prej tyre. Unë e mora para mbledhjes raportin, të cilin e kisha, por ju shkua dhe nuk e diskutuam më, por ju po kërkoni që ne me u bërë pjesë e shërbimit. Ju e keni shumë lehtë që, në emër të grupit parlamentar apo si doni, me bërë një kërkesë direkt në kompaninë Bifurkacioni. Ata janë monitorues, menaxhues dhe përgjegjës për ujin. Mirë, ndoshta që po e paraqet një gjendje jo të mirë, por është një gjendje ndoshta dy-treqind herë në përqindje më të madhe se kur ju jeni kanë vetë menaxhues të çështjes së ujit. Së bashku me drejtorin ishim në fabrikë dhe nën një ishin turbullirat dhe, sipas tyre, kur është nën një turbullira, është i pijshëm. Ata e thonë se unë nuk jam ekspert, as hidrolog, as nuk jam kimist për me ditur, por problem mund të jetë në rrjet që e kemi thënë ndoshta me dhjetëra herë. E ne po mundohemi me ndërruar rrjetin dhe me vendosur të ri, dhe me parë deri në fund se çka po bëhet, duke e përmirësuar cilësinë e ujit në ndërrimin e rrjetit të ri dhe duke i eliminuar humbjet në rrjet.

Sead Vila thekson: Te ndarja e subvencioneve gjithmonë e dimë që janë të mirëseardhura për pjesën e cila merret me bujqësi, por ajo çka është shqetësuese është se më trembëdhjetë maj është bërë ndarja e subvencioneve për multikultivatorët me frezë dhe i kam vërejtur tri mangësi. E para është politike, e dyta është familjare, e treta është se janë përfitues të shumëfishtë. Ne e dimë që nuk ka shumë fermerë, por do të ishte mirë që me u bërë një gjithëpërfshirje, sepse dikush që nuk ka përfituar asnjëherë është dashur me ia dhënë mundësinë që me motivuar që edhe ai ne ta punon tokë ose ne të merret me veprimtari të tilla. Më shqetësuese dhe zhgënjyese për qytetarët e Hanit të Elezit është se, pasi është finalizuar lista përfituese, në momentet e fundit apo sa kohë para publikimit final, keni dalë me një listë tjetër finale dhe qytetarët i kanë të dy listat në teren, dhe kjo nuk është e mirë, se qytetarët i kanë marrë informatat që janë përfitues dhe pastaj i kanë hequr nga lista. Kërkoj arsye se pse janë hequr dhe, nëse flasim për meritokraci, do të ishte mirë që edhe këto t'i përfshijmë, për shkak se ka dikush prej tyre që nuk ka përfituar asnjëherë. Do të ishte mirë që edhe në lagjen tonë të jetë ndonjë përfitues, pra do të ishte mirë të bëhet gjithëpërfshirje, që edhe ata të cilët nuk kanë përfituar asnjëherë të jenë përfitues nga donacionet e ndryshme të cilat vijnë nga jashtë.

Abduraman Bushi thekson: Sa i përket këtyre subvencioneve, këto i ka dhënë shoqata. E dyta, te çështja e listave, nuk ka dy lista. Te ajo listë që ju e keni parë, shikojeni, i ka tridhjetë numra. Kur kanë vendosur me i dhënë subvencionet, më kanë thirrur në Prishtinë dhe kanë potencuar që duhet ta bëni një listë prej tridhjetë personave, për shkak se ata kanë menduar se më shumë se tridhjetë persona nuk ka dhe kanë aplikuar gjashtëdhjetë e katër persona. Ata kanë pasur me i shpërndarë njëzet multikultivatorë dhe, kur ua kam dërguar listën që kanë aplikuar gjashtëdhjetë e katër persona, jemi dakorduar që me i bërë dy lista nga tridhjetë e dy persona dhe me dalë në teren shoqata me disa shoqërues të komunës. Zyrtari i TIK-ës ka dalë në teren dhe, kur ka dalë në teren, ka dalë me atë listën që po e potencon ti. Ajo listë është bërë pasi ka përfunduar afati për aplikim, pra ditën e hënë. Kur kam filluar me bërë listën, zyrtari i TIK-ës ka potencuar që ta bëjmë në bazë të regjioneve, në mënyrë që kur të dalim në teren me një fshat, t'i shikojmë të gjithë ata, dhe e kam lënë atë listë. Kam filluar me bërë listën tjetër në bazë të kërkesave të atyre. Pas njëzet e një ditësh ka ardhur komisioni prej atjeshëm, ka dalë në teren dhe i ka vizituar fermerët. Pas vizitës nga tereni, anëtari i komisionit nga TIKA ka potencuar që nga të gjithë fermerët që i kam vizituar, prej tyre i kam përzgjedhur njëzet persona dhe e kanë përpiluar listën dhe ma kanë dërguar. Familjarë, i tërë Hani i Elezit jemi të lidhur dhe nuk mundemi me shkuar jashtë Hanit të Elezit. Edhe përfaqësuesve të TIK-ës ju kam potencuar që t'i zbatojnë kriteret kryesore, që ata të cilët jetojnë prej bujqësisë t'ju jepet prioritet. Ne ju kemi dhënë multikultivatorë edhe atyre që nuk na kanë votuar, por ata i sigurojnë të ardhurat nga bujqësia. Jemi munduar që ta përfshijmë edhe pjesën gjeografike. Komisioni, kur ka dalë në teren, e ka pasur një pyetësor që ua ka parashtruar aplikuesve dhe i ka pyetur se a keni pasur ndonjëherë pajisje bujqësore. Janë përgjigjur po, por e kemi shitur, dhe i kanë eliminuar. Pra, janë disa kriteret të cilat krejt më vishen mua, por TIKA i ka përzgjedhur. Ky proces do të vazhdojë edhe në të ardhmen dhe të gjithë do të përfitojnë.

Kryesuesi thekson: Pajtohem plotësisht me z. Sead Vila se përzgjedhja e këtyre, në bazë të drejtorisë që potencojnë se ka ardhur komisioni dhe ka vendosur në terren, nëse ai komision i jep dikujt traktor që nuk ka asnjë metër tokë që punohet, ai nuk është komision. Te çështja e përfituesve, qartë shihet se ka pasur listë edhe më herët dhe nuk ka qenë e nevojshme me dalë e me u publikuar, e ndoshta edhe me u fjalosur individët mes vete pse mua ma m'шон vijë e merr ti në emrin tim, e që kjo është hala më e keqe. Shumë ka zgjatur çështja e përfituesve, por më shqetësuese është kur përfiton zyrtari komunal para qytetarit. Kjo është për të ardhur keq, që kjo më pengon, sepse aplikojnë në emër të grave, në emër të vëllezërve, ndërsa kurrë nuk e përdorin atë mjet që e përfitojnë. Unë nuk them që nuk duhet të përfitojë një zyrtar komunal, nëse me të vërtetë e punon tokën, por është një far rendi që të paktën qytetari të na vijë në rend para atyre zyrtarëve. Është shqetësuese për mua se qytetari vazhdimisht është duke u ankuar në këtë përzgjedhje që është bërë dhe nuk kam ditur edhe çka me ju thënë.

Abduraman Bushi thekson: Ne, edhe kur i kemi dhënë sa kanë aplikuar, pra tri herë më ka ndodhur që kemi dhënë sa kanë aplikuar, dhe kur kam dalë nëpër kafiteri më kanë thënë që i keni dhënë me të njohshëm. Unë e di që edhe ata të cilët kanë aplikuar ndoshta e kanë merituar, por mundësi ka qenë për njëzetë. Në listë ka ndoshta edhe zyrtarë, por edhe ata janë qytetarë të Hanit të Elezit dhe nuk mund të bëjmë diskriminim, se ndoshta më herët nuk kanë marrë, por i kanë marrë tash për shkak se nuk kemi mundësi me ju dhënë të gjithëve për një herë.

Sead Vila thekson: Ne nuk mundemi me mohuar që komuna jonë nuk ka përfituar vazhdimisht edhe në të kaluarën, edhe në të tashmen. Ndoshta shumë komuna nuk e kanë këtë përparësi. Nuk është e vërtetë që dy listat janë me numra të ndryshëm, por të dy listat janë me nga njëzetë. Si mundemi na të tjerët me prit në të ardhmen? Ndoshta më e arsyeshme kishte qenë që ti dhe të tjerët që keni marrë disa herë të pritni për në të ardhmen me marrë, e këto që nuk kanë marrë asnjëherë, me ju dhënë mundësi tash.

Menduh Vlasi thekson: Komisionin nuk është mirë me përmendur se i shkojnë se kush ka me marrë. Kërkoj që për mbledhje të ardhshme me bërë një raport për katër vite: sa traktorë janë dhënë, sa serra janë dhënë. Jam për me dhënë dhe, siç po thoni, kanë me marrë krejt dhe ishalla krejt marrin. Mas së mrami, apo hiç, nuk marr unë, por nuk është problemi këtu. Mirëpo, problemi është se po ju jepni personave që nuk e shfrytëzojnë. Unë di person që e ka marrë traktorin dhe e ka shitur, ka marrë serrë dhe i mban shpezët. Unë edhe Sharrcemit i kam thënë, për shkak se ka investuar shumë përmes Labit, sa janë funksionalë.

Sherif Bushi thekson: Kompania e cila i ka kryer disa punime të varrezat e qytetit ka shkaktuar një dëm, duke i dëmtuar mbrojtëset e Urës së Fezës. Banorët e asaj pjese kërkojnë që ai dëm të rregullohet sa më shpejt që është e mundur, pasi që paraqet rrezik për kalimtarët, por një rrezik më i madh është për fëmijët të cilët kalojnë atë urë për të shkuar në shkollë. Kërkoj që sa më shpejt që është e mundur të intervenohet. Ju drejtohem drejtorëve që të dalin në terren, që t'i kontrollojnë punimet, sepse keni ardhur me atë premtim që keni me nejtë më shumë në terren e jo në zyre. Me vete kam disa fotografi për dëmtimin e asaj pjese. Çështja e qenve endacakë në komunën tonë është bërë bukur shumë, e një grup i qenve endacakë qëndrojnë afër shkollës fillore Ilaz Thaçi. Jam dëshmitar ku para disa ditësh një nxënës është sulmuar nga disa qen endacakë, por për fat të mirë aty ka qenë një person që e ka një biznes privat dhe një punëtor i ETC-së, të cilët kanë intervenuar me kohë. E dimë që është magjistratja aty dhe mundet, duke u mbrojtur nga qentë endacakë, me ndodhë ndonjë fatkeqësi më e madhe. Sa i përket koalicionit bashkëqeverisës, është mirë që LDK-ja t'ju tregojë qytetarëve se është në koalicion me PDK-në në Han të Elezit, pasi që një pjesë e qytetarëve po mendojnë që LDK-ja është pjesë e opozitës. Për mua, aq sa ka faj PDK-ja për mospunë dhe neglizhencë, moszhvillim të Hanit të Elezit, familjarizim në punësim, përçarje në mes punëtorëve të administratës, po aq faj ka edhe LDK-ja, pasi që udhëheqin me tri drejtori dhe jeni tre asamblistë të cilët ia votoni të gjitha pikat PDK-së. Edhe në mbledhjen e fundit të Kuvendit Komunal, kur është bërë bartja e mjeteve për blerjen e veturës për nevojat e kabinetit të kryetarit, është mirë që qytetarët ta dinë se me vota të PDK-së dhe të LDK-së ajo pikë ka kaluar, edhe pse ne, AAK-ja dhe LVV-ja, kemi votuar kundër. E dimë që një pjesë e qytetarëve nuk mund ta përcjellin lajv transmetimin e seancës dhe është mirë që atyre t'ju tregohet për të gjitha vendimet të cilat i merrni përmes votës suaj, e jo t'ua tregoni vetëm fjalimet të cilat i merrni në Kuvend, sepse qytetarëve të komunës sonë ua kemi borbë të vërtetën.

Medina Imishti thekson: I ka tre muaj që i kam kërkuar disa përgjigje me shkrim nga kompania Pastrimi dhe besoj që përgjegjësia bie mbi Drejtorinë për Shërbime Publike. Shpresoj që m'i përcjellë dhe, meqë afati është gjashtëdhjetë ditë, kanë kaluar tre muaj. Ne i kemi parë disa konkurse që janë shpallur dhe kanë përfunduar në sektorin e shëndetësisë. Kanë qenë tre mjekë dhe pesë infermierë, dhe meqë ka qenë një numër i madh i infermierëve me baçelor që kanë aplikuar, pse janë shpallur dy pozita me shkollë të mesme dhe tri me baçelor? Dy prej tyre ishin me mbiemër Ballazhi, po më intereson të di se a kanë lidhje familjare me kryetarin.

Senad Kalsi thekson: Te ajo pjesë që është e dëmtuar, deri më tani nuk kemi pasur kontratë për shërbimet e saldimit dhe sot e kemi përcjellë për zyrën e prokurimit lëndën dhe besoj që shumë shpejt ajo pjesë ka me u rregulluar. Çështja e qenve endacakë nuk është vetëm shqetësim i yni komunal, por edhe shtetëror, mirëpo përderisa shteti nuk e ka një plan se çka me bërë, ne nuk mundemi me ndërhyrë veç e veç si komunë.

Nexhmedin Daci thekson: Ne jemi në koalicion me PDK-në me vullnet të lirë, por nuk do të thotë se në çdo pikë ne mendojmë njëjtë. Ne nuk jemi shkrirë si parti, por jemi pozitivë këtu e jo opozitë, pavarësisht faktit që si individë kam shumë dallime në shumë fusha, por ne bashkëpunojmë për interes të qytetarëve.

Visar Hasallari thekson: I nderuar z. Sherif Bushi, Lidhja Demokratike e Kosovës, dega në Han të Elezit, është pjesë e koalicionit dhe, nëse ti mendon që politika kur të bëhet në koalicion voton gjithçka që na servohet, e ke gabim. Për çështjen e votimit, secili këtu, edhe ti edhe unë, votojmë në bazë të bindjeve të cilat i kemi dhe nuk do të thotë që, nëse ti një pikë nuk e voton, nuk je pjesë e koalicionit. E keni shumë gabim.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:20.

Procesmbajtësi
Avni Bushi

